

Doc. Dr. Shaban Sulejmani\*  
Mr. Sci. Rahim Jashari  
Mr. Sci. Salim Sulejmani

## DËSHMITARI I MBROJTUR DHE PESHA E DËSHMISË SË TIJ NË PROCESIN PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË (RM)

### 1. Dëshmitari dhe roli i dëshmisë së tij në të drejtën zakonore dhe atë të sheriatit islam

#### 1.1. Vështrim i përgjithshëm mbi dëshmitarin në përgjithësi dhe dëshminë e tij

Dëshmitari, si mjet provues i shpeshtë, nëpër ligjet dhe teoritë e procedurave penale, nuk është i paraqitur njëlloj dhe për këtë arsye hasim definicione të shumta. Ajo çfarë mund të vërejmë nga definicionet e dhëna për "Dëshmitarin", është në të gjitha ato bëhet vetëm përshkrimi i tij<sup>(1)</sup>.

Meqenëse nga dëshmitari kërkohet që të dëshmojë drejt, shoqëria duhet t'i ofrojë atij mbrojtje të nevojshme, në mënyrë që të mos përjetojë situata të pakëndshme për shkak të dëshmisë së bërë nga ai, apo të jetë kërkuar. Në Kodin e Procedurës Penale të RM-së, është dhënë përkufizimi i dëshmitarit, në të cilin thuhet se "si dëshmitarë thirren personat për të cilët është e besueshme se do të mund të japin të dhëna për veprën penale dhe për rrethana të tjera të rëndësishme"<sup>(2)</sup>.

Pra, sipas këtij përkufizimi, si dëshmitar në procedurë penale thirret çdo person i cili besohet se do të ofrojë informata për ngjarjen penale dhe jo vetëm, por edhe për autorin e veprës penale

\* Ligjërues në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, në RM.

<sup>1</sup> Sahiti E, Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale, Prishtinë, 1993, f. 59.

<sup>2</sup> Neni 237 al. 1 i Ligji i Procedurës Penale, i shpallur në "Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë", (Tekst i rishikuar) f. 80, nr.17, datë 07. 03. 2005.

dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale. Sipas kësaj zgjidhjeje të ofruar ligjore, në cilësinë e dëshmitarit mund të paraqitet çdo person, pa bërë një dallim dhe kufizim të moshës ose gjinisë, e që mjafton vetëm ai/ajo të ketë njohuri për ngjarjen me pasoja të ndaluara penale, si dhe për autorin e veprës penale dhe rrethanat, jo çfarëdo, porse ato relevante që do të kontribuonin në zbardhjen e një çështjeje të caktuar penale.

Po ashtu, në Ligjin me nr.38/05 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve”, është dhënë përkufizimi “Person i mbrojtur”, që realisht ka të bëjë pikërisht me “dëshmitarin”, për të cilin vihet zbatim masa e mbrojtjes. Sipas ligjit në fjalë, person i mbrojtur është “Dëshmitari, bashkëpunëtori i drejtësisë, viktimi, e cila paraqitet në cilësinë e dëshmitarit si dhe të afërmit, të cilët me vendim të Këshillit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve futen në programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, me të cilin seksioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ka të nënshkruar marrëveshje për mbrojtje”<sup>(3)</sup>.

Është fakt i pamohueshëm që dëshmitarët luajnë rol jetik për zgjidhjen e drejtë të një çështjeje të caktuar penale. Ndodh që jo rrallëherë dëshmia e dëshmitarit të jetë provë e vetme në procedurë penale<sup>(4)</sup>. Roli i dëshmitarit është evident në raport edhe me provat të tjera që shërbejnë për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale. Prandaj, duke pasur në konsideratë peshën e kësaj prove edhe KPP-ja përmban një sërëdispozitash lidhur me “mbrojtjen e dëshmitarit” në procedurë penale. Këto dispozita, janë të rëndësishme, jo thjesht për mbrojtjen e këtyre personave, porse edhe për familjet e tyre, për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale në tërësi, si dhe për ndriçimin sa më të plotë të gjendjes faktike të një çështjeje konkrete penale, e sidomos në ato raste kur dëshmia e tyre, në çdo ngjarje me pasoja të ndaluara penale e veçanërisht në ato të rëndat, paraqet mjet të rrallë prove. Që dëshmia të jetë funksionale në atë masë qëduhet, e që kjo arrihet kur ata mbrohen, ligjdhënësi ka qenë i kujdesshëm dhe ka paraparë mundësinë ligjore që ndaj dëshmitarit të caktuar të aplikohen masat e mbrojtjes në kuadër të ligjit.

Shumica e vendeve të rajonit kanë miratuar ligje të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe kanë krijuar një praktikë solide

<sup>3</sup> Neni 2 i LMD-së.

<sup>4</sup> Sahiti, E, Argumentim në procedurën penale, Prishtinë, 2006, faqe 221.

të zbatimit, e në kuadër të tyre mund të përmendim Kroacinë. Me keqardhje duhet të konstatojmë se për shkak të shumë rrethanave që kanë mbretëruar gjer në momentin e tanishëm në Maqedoni, “mbrojtja e dëshmitarëve” vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore për sistemin e drejtësisë penale. Për shkak të kërcënimeve të ndryshme psikike, por dhe fizike, të ushtruara nga ana e atyre që rrezikojnë burg më afat të gjatë vuajtje lirie, ndaj dëshmitarëve potencialë, dëshmia e të cilëve vlerësohet të jetë e rëndësishme së veçantë, në raste të shumta ata refuzojnë tërësisht t’i tregojnë ato informacione dhe të dhëna të rëndësishme që i dinë vetëm ata.

### *1.2. Dëshmia e dëshmitarit në të drejtën zakonore shqiptare*

Shqiptarët një kohë të gjatë kanë pasur pozitë gjeografike të jetesës së tyre në vende rurale dhe rregullimi i marrëdhënieve bëhej në bazë të rregullimit fisnor. Këto rregulla ishin të përmbledhura nëpër kanune. Kanuni me zbatueshmëri më të gjerë ishte ai i Lekë Dugagjinit, në të cilin përmblihdeshin të drejtat zakonore shqiptare. Meqë mungonte struktura organizative, që nënkupton mungesën e pushtetit qendror, që do të zbatonte juridiksion për një periudhë të gjatë kohore, u desh që në atë shkallë të zhvillimit shoqëror që po kalonin shqiptarët të kishin një institucion që do të zgjidhte konfliktet dhe do të vendoste për çështje të ndryshme faktike dhe ato të sferës juridike. Ky institucion që u njoh ishte gjyqi popullor, në të cilin funksionin gjyqësor e ushtronte pleqnia – gjyqi i pleqve, i cili konstituohej ekskluzivisht për një çështje konkrete.<sup>(5)</sup>

E drejta zakonore shqiptare në mesin e provave racionale njeh edhe dëshminë e dëshmitarit, dhe dëshmitarin si mjet provues, i cili më shpesh paraqitet në çështje civile se sa në ato penale. Dëshmia, si provë, ishte aq restriktive, saqë në rast se dëshmohej në dëm të anëtarit të fafesisit do të klasifikohej si tradhti. Prandaj ajo më pak mund të përdorej si provë akuzuese. Për dëshmi të rrejshme ndaj dëshmitarit mund të zbatoheshin masa ndëshkuese me bojkotim. Për mosofrim të dëshmisë, kur kërkoheshin nga ata, nuk parashihej ndonjë masë sanksionuese. Pleqnia këtë provë, si dhe

---

<sup>5</sup> Ibid, f. 31.

çdo tjetër, e vlerësonte sipas bindjes së lirë.<sup>(6)</sup>

Një periudhë të gjatë kohore në trojet shqiptare është zbatuar edhe e drejta e shariatit. Prandaj, mendoj se mund t'i kushtoj pak hapësirë edhe kësaj të drejte, rreth asaj se çfarë përmbajtje ka pasur dëshmia e dëshmitarit, e njohur si provë në procedurën penale islame.

### 1.3. Dëshmia e dëshmitarit në të drejtën e shariatit

Në mesin e provave racionale që i njeh e drejta e shariatit, nuk ka munguar edhe dëshmia e dëshmitarit që kishte një pozitë të rëndësishme, apodominante. Me nocionin „dëshmi „, sipas kësaj të drejte, nënkuptohej deklarimi i një personi me qëllim të argumentimit të së drejtës së dikujt, me shprehjen „dëshmoj në seancë gjyqësore „<sup>(7)</sup>, e disa të tjerë e definojnë si *“Deklaratë për çështje të cilat i ofron dëshmitari e të cilat i ka perceptuar ai vetë”*<sup>(8)</sup>. Varësisht nga nevoja për të dëshmuar dhe roli i saj në zhvillimin e procedurës, kur dihet se nuk ka dallim mes procedurës së të drejtës civile dhe penale, mund të arrihte në shkallë të obligueshmërisë së patjetërsueshme. Kjo situatë ishte paraparë për ato raste, kur nga individët që kishin parë a dëgjuar për ndonjë fakt, duhej një dëshmi, sepse po të mos provohej me provë, do të humbte e drejta e ndokujt.<sup>(9)</sup> Në Ku`ran thuhet *“Mos e fshihni dëshminë, sepse ai që e fsheh ate, ai është mëkatar...”*<sup>(10)</sup>. Dëshmia mund të jetë e obligueshme, mirëpo jo aq e patjetërsueshme, në rastet kur i dëmtuari nuk e di se ka individë që mund të ofrojnë njohuri për ndriçimin e ndonjë fakti, dhe me atë rast mund të humbasë e drejta e palës së dëmtuar. Profeti Muhamed a.s. thotë: *“A doni t`ju informoj se cila dëshmi është më e mirë? Më e mira është ajo që ofrohet para se të kërkohet nga dëshmitari”*<sup>(11)</sup>. Dhe dëshmia mund të jetë edhe fakultative, atëherë kur para gjykatës ka një numër të mjaftueshëm

<sup>6</sup> E. Sahiti, vep. e cit., f. 31 – 33.

<sup>7</sup> Vehbe Zuhejli, Fikhul islami ve ediletuhu, Damask 1989, f. 556.

<sup>8</sup> F. Ebu Safijeh, Turuk el-ithbat fi kadail islami, Irbid 1994, f. 36.

<sup>9</sup> Ibid, f. 40.

<sup>10</sup> Kaptina el-Bekare, 282.

<sup>11</sup> Muslimi, Sahih Muslim (Koleksioni i hadiseve të imam Muslimit), bleni 4, kapitulli “ Hajru shuhud “-Dëshmitarët më të mirë, Kairo 1989, f. 18.

të dëshmitarëve dhe të provave tjera, kurnuk ekziston rreziku që pala e dëmtuar të humbë të drejtën e tij në kontestin gjyqësor.<sup>(12)</sup> Për sa i përket kualiteteve që duhet të ketë dëshmitari me rastin e dëshmisë, me disa përjashtime janë të njëjta, si në njërën po ashtu edhe në tjetrën procedurë. Kështu pra, personi i cili paraqitet në cilësinë e dëshmitarit duhet të plotësojë disa karakteristika, si: ai duhet të jetë i rritur, psikikisht i shëndoshë, i lirë, të mos jetë i verbër, të mund të flasë, të jetë i drejtë, që nënkupton se duhet që të mos jetë mëkatar. Sipas imam Ebu Hanifes, përpos në dënime *Hadd*<sup>(13)</sup>-taksativisht të përcaktuar dhe *Kisas*<sup>(14)</sup>-gjakmarje në formë të hakmarrjes, mjafton që dëshmitari në aparcencë të jetë i drejtë<sup>(15)</sup>, që përkundër dy nxënësve të tij, Ebu Jusufi dhe Muhamedi, të cilët kushtëzojnë të hulumtohet rreth personalitetit të tij, e kryer me dy forma, haptazi dhe fshehurazi<sup>(16)</sup>. Ndërkaq, dëshmitari i karakterizuar si person i karakterit jo të mirë, sipas të gjithë juristëve islamë, që rreth kësaj çështjeje janë unikë, është se po të pendohej dhe përmirësohej, atëherë dëshmia e tij pranohet. Përjashtim bën Ebu Hanifja, i cili thotë se shpifësi ndaj grave<sup>(17)</sup> të

<sup>12</sup> Vehbi Zuhejli, Fikhul islami ve ediletuhu, Damask 1989, f.557-8.

<sup>13</sup> Sipas legjislacionit penal islam, Ligjvënësi (Allahu xh.sh.) për disa lloje të veprave penale ka përcaktuar sanksionet penale në mënyrë taksative që njihen me emrin Hadd, që për vërtetimin e këtyre veprave penale kriteriumi është shumë i rreptë. Gjegjesisht, për vërtetimin e këtyre veprave penale, përveç vetëpranimit, numri më i madh i juristëve islamë llogarisin dëshminë e katër dëshmitarëve, të cilët duhet të plotësojnë një mori kushtesh për të qenë e sanksionuar vepra penale me lloje të sanksioneve Hadd. Me këtë rast, këto sanksione nuk mund të falen, as krejtësisht të zbuten apo të ashpërsohet dënimi ndaj atyre që kanë kryer këto lloje të veprave penale, si: vjedhje, grabitje, adulteri, shpifje për prostitucion, konsumim të pijeve dehëse, renegim dhe rebelizëm.

<sup>14</sup> Nga mesi i sanksioneve më të ashpra që parasheh legjislacioni penal islam konsiderohet edhe gjakmarrja kisasi, qëpërdoretvetëm për veprën penale të vrasjes me paramendim katlul amd. E drejta e kërkimit për t'u ekzekutuar ky sanksion është e palës së dëmtuar, e cila mund t'i falë atij që ka kryer veprën penale,apo të kërkohë dëmshtëpërblim gjegjesisht kompensim material, si një lloj sadsifaksioni për dëmin e shkaktuar të dëmtuarve, gjegjesisht trashëgimtarëve të viktimës.

<sup>15</sup> Ibid, f. 565.

<sup>16</sup> El-Kasani, Bada`iu sanai, Bejrut 1997, f. 273-93.

<sup>17</sup> Me këtë rast nuk duhet nënkuptuar fakti se shpifja e kryer ndaj meshkujve

ndershme për prostitucion, edhe në qoftë se pendohet, dëshmia e tij nuk mund të merret si provë që të administrohet në asnjë kontekst gjyqësor.<sup>(18)</sup> Po ashtu, karakteristikë tjetër është që dëshmitari të mos jetë i dyshimtë për objektivitet, me atë që kur të paraqitet për të ofruar dëshminë, ekziston mundësia që ai për shkak të lidhjes së gjakut, afërsisë familjare etj., të akuzuarit t'i sjellë dobi. Pra, me ndihmën e dëshmisë së tij, i akuzuari mund ta fitojë procesin gjyqësor, apo kjo dëshmi mund të pengojë sanksionin që mund ta godasë palën e akuzuar<sup>(19)</sup>. Kategoria e personave që nuk mund të dëshmojnë është e madhe, e në lidhje me këtë profeti Muhamed a.s. thotë:

*“Nuk lejohet të administrohet si provë dëshmia e keqpërdoruesit të detyrës, mashkull qoftë a femër, e as ai e as ajo ndaj të cilëve janë shqiptuar masa sanksionuese me kamxhikim, e as e atyre që janë në urrejtje mes vetes, e as që ka dhënë dëshmi të rrejshme, as shërbëtori i familjes që është në proces gjyqësor, e as ai që ka bërë dredhi e tradhëti gjatë detyrës së postit të kujdestarisë e as nga afërsia e gjakut”<sup>(20)</sup>.*

Kështu, për shembull, nuk mund të dëshmojë prindi për djalin e as djali për prindin e as për gjyshin, as i hidhëruari për të hidhëruarin.<sup>(21)</sup> Gjithashtu dëshmia e femrës, edhe pse krejtësisht nuk ishte e eliminuar, ajo nuk mund të dëshmonte për vepra penale që si sanksion mund të futeshin te dënimi hadd. Ajo, sipas imam Ebu Hanifes, mund të paraqitej edhe si dëshmitare e vetme në ato çështje që kanë të bëjnë me natyrën që i përkisnin gjinisë femrore, si çështje që kanë të bëjnë me lindjen, gjidhënien, virgjinitetin etj.<sup>(22)</sup> Po ashtu, ajo mund të paraqitej si dëshmitare në kontekste civile, të së drejtës familjare etj., si për shembull, gjatë kurorëzimit, shkurorëzimit, gjatë lidhjeve të kontratave,

---

lejohet, ku dhe me këtë rast shpifësi i tillë do të llogaritet. gjithashtu jo i denjë për të ofruar dëshmi.

<sup>18</sup> F. ebu Safijeh, Turukul ithbat fil kadail islami, Irbid 1994, f. 58.

<sup>19</sup> Vehbe Zuhejli, vep. e cituar, f. 568.

<sup>20</sup> Es-San`ani, Subuli selam, Kairo 1987, f. 246 - 7.

<sup>21</sup> V. Zuhejli, Fikhul islami ve ediletuhu, Damask 1989, f. 568

<sup>22</sup> Ibid.

marrëveshjeve të ndryshme, testamentit, dhuratës etj. Mirëpo, edhe në këto raste, dëshmia e saj ishte e përgjysmuar, e që për t'u llogaritur e plotë nevojiteshin dy gra.<sup>(23)</sup> Varësisht nga rastet penale, numri i nevojshëm i dëshmitarëve është i ndryshueshëm.<sup>(24)</sup> Edhe pse sigurimi i numrit të kërkuar të dëshmitarëve nënkuptonte teorinë legale të vlerësimit të provave, *kadiu*-gjykatësi, si subjekt procedural, përveç grumbullimit të provave, vendimin gjyqësor e mbështeste vetëm edhe nëse ishte i bindur në saktësinë e atyre provave.<sup>(25)</sup>

Sipas Ebu Hanifes, jomyslimani mund të paraqesë dëshminë si provë kundër jomyslimanit i cili jeton në shtetin islam, ndërsa nuk pranohet dëshmia e jomyslimanit i cili jeton jashtë shtetit islam kundër jomyslimanit që jeton në shtetin islam.<sup>(26)</sup>

Me zhvillimin dhe ndryshimet e mëdha të kushteve shoqërore – ekonomike, situata, për sa i përket dëshmisë së jomyslimanit për myslimanin, ndryshoi krejtësisht, me atë që jomyslimani mund të jetë dëshmitar në disa çështje të së drejtës civile. Kështu, për shembull, në kuadër të shteti osman, të periudhës së vonshme, i cili ishte prezantues i islamit, nuk merrej aq shumë parasysh prejardhja etnike dhe manifestimi fetar, porse vlera e individit, duke u mbështetur në orientimet politike të disa shtresave shoqërore<sup>(27)</sup>.

<sup>23</sup> F. ebu Safije, Turukul ithbat..., Irbid 1994, f. 68-9.

<sup>24</sup> V. Zuhejli, Fikhul islami..., Damask 1989, f. 567-72.

<sup>25</sup> Fakhri ubu Safijeh, vep. e cit., Irbid 1994, f. 113-4.

<sup>26</sup> Ibid, f. 584-5.

<sup>27</sup> Dragolub Janković, Istorija drzave i prava jugosllavenskih naroda (gjer më 1919), Beograd 1962, cituar sipas E. Sahitit, vep e cit., f. 35; duke cekur dr. Muhamed Zuhejli ndryshimet e mëdha të bëra në fushën legjislativë të disa shteteve të reja që po krijoheshin para se definitivisht të shembej Perandoria Osmane. Kështu ndodhi edhe "me Republikën Arabe të Sirisë në kufijtë e sotëm që ka, e që gjatë sundimit osman nuk ishte shtet i pavarur, por prej vitit 1856 e këtej filluan të funksionojnë institucione dhe ligje shtetërore, të ndara nga ato sheriatike. Kështu, më 1879, pushteti osman futi në fuqi ligjin e procedurës civile, dhe më 1858-n nxjorri Kodin Penal Osman etj., dhe me këtë rast u themeluan gjykata të shkallës së parë, ato të apelit, gjykata penale etj. Ky ndryshim i tërë, në sferën e judikaturës, të sistemit gjyqësor etj., ndodhi për shkak të ndryshimeve të mëdha në rrafshin shoqërore – ekonomik që po ngjante në botë, e detyroi edhe botën islame, prezantuese e së cilës ishte shteti

E drejta e shariatit i kushton kujdes të veçantë kësaj prove, ku njëherazi dhe kryesisht mbështetet në sistemin provues.

## 2. Dëshmitari dhe mbrojtja e tij në shoqërinë bashkëkohore

Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (në tekstin e mëtejshëm LMD) i Republikës së Maqedonisë është i qartë në atë që ky ligj përfshin tri kategori të personave të cilët mund të paraqiten si dëshmitarë, që të marrin trajtën e dëshmitarit të mbrojtur.

Mbrojtja e dëshmitarëve konsiderohet si një ndër problemet kyçe të sistemit të drejtësisë në Maqedoni dhe në vendet e tjera<sup>(28)</sup>. Për këtë qëllim, shoqëria bashkëkohore duhet patjetër t'i kushtojë rëndësi edhe më të madhe mbrojtjes së dëshmitarëve. Me këto ligje adresohet çështja e masave mbrojtëse, kuptimi dhe llojet e tyre, kushtet që duhen plotësuar për aplikimin e masave të tilla, koha e vlefshmërisë së tyre e të tjera.

Rëndësia e mbrojtjes së dëshmitarëve në shoqëritë bashkëkohore është rrjedhojë e faktit që në kushtet aktuale janë të shpeshta rastet kur atyre për dëshminë e dhënë, u kanoset jeta e vetë, madje – madje edhe jeta e familjarëve të tyre. Kjo mbrojtje, pavarësisht avancimeve që ka shënuar, akoma mbetet larg asaj që në realitet ekzistojnë nevojat për një gjë të tillë. Shkaqet e kësaj gjendje janë të shumta dhe të llojllojshme. Ato i referohen mentaliteteve ekzistuese si dhe gjendjes ekonomike të shteteve përkatëse.

Mbrojtja e dëshmitarëve sot kërkon ndërtimin e një infrastrukture përkatëse, përfshirë atë të ndërtesave, por edhe

---

osman, në mënyrë kritike t'i shohë disa çështje", thekson Muhammed Mustafa Ez-Zuhejli, *Usul muhakemat esh-sher' iije vel medenije*, Damask 1982, f. 94-96.

<sup>28</sup> Kërcënimi ndaj dëshmitarëve sanksionohet penalisht, por fatkeqësisht këtë dekadë të fundit në gjykatën maqedonase praktikisht nuk ka informata se është inicuar një procedurë për përgjegjësi penale ndaj personave që kanë ndikuar ose frikësuar dëshmitarë, të kategorisë së dëshmitarëve të mbrojtur. Në një nga lëndët penale, ku ishin dëgjuar "dëshmitarët e kërcënuar", (si në rastin "Detonator") kryetari i trupi gjykues raporton se ka marrë kërcënime gjatë zhvillimit të seacave gjyqore dhe në ato raste u është drejtuar të pandehurve të mos e kërcënonin, cituar sipas Sashe Dimovski, "Заштитен сведок како инструмент во македонскиот правен систем", (Dëshmitari i mbrojtur si instrument në sistemin e drejtësisë maqedonase), Bato & Divajn, Shkup, maj 2014.

lidhjen e marrëveshjeve me shtete të ndryshme që mundësojnë strehimin e dëshmitarëve të tillë (sidomos të dëshmitarëve kyç që dëshmojnë për krime të rënda) në vendet e treta për një kohë të caktuar apo përgjithmonë, si dhe mundësi të tjera që adresojnë çështje të mbrojtjes së identitetit të dëshmitarit. Maqedonia, si shumica e vendeve të tjera, sidomos e atyre nga Ballkani, të përballura me këto vështirësi, nuk është në gjendje të sigurojë kushtet adekuate të kësaj mbrojtjeje.

### 3. Qëllimi dhe aspektet e mbrojtjes së dëshmitarëve

Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në RM, është në drejtim të kontributit të parandalimit dhe të luftës kundër çdo lloj kriminaliteti. Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën penale paraqet bazën dhe parakushtin kryesor për shtypjen efektive të kriminalitetit në përgjithësi dhe shkakton rritje të efektivitetit të drejtësisë penale. Zbatimi i vazhdueshëm i këtij ligji kontribuon dhe patjetër që avancon zbatimin në kohë dhe në mënyrë efikase të autoriteteve kompetente në zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e kriminelëve nga fusha e krimit të organizuar, por në të njëjtën kohë krijon parakushtet reale për neutralizimin e rrezikut të bllokimit (të mundshëm) të sistemit të drejtësisë penale. Qëllimi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë është në interesin e drejtësisë. Një nga arsyet është fakti që dëshmitari, si një mjet provues në procedurë penale, të deklarohet lirshëm dhe pa asnjë lloj ngarkese që atij mund t'i shkaktohet ndonjë dëm nga kushdo qoftë. Arsyeja tjetër ka të bëjë me aspektin human, e që konsiston në mbrojtjen e dëshmitarit si pjesëmarrës në çështje penale që të vazhdojë jetën dhe aktivitetet, i sigurtë, pa asnjë pasojë pas dhënies së dëshmisë së tij në një çështje penale. E në anën tjetër, qëllimi i masave të mbrojtjes është që të mbrohen dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë përmes caktimit të masave të posaçme dhe urgjente të mbrojtjes, e gjitha kjo e paraparë në nenin 26 të LMD-së. Në fakt, dispozitat e LMD-së, ofrojnë masa të mbrojtjes për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë në shumë aspekte, si:

1. *Mbrojtje dhe siguri fizike për vete dhe për anëtarët e ngushtë të familjes;*
2. *Mbështetje financiare;*
3. *Mbështetje shoqërore, juridike e tjera.*

#### 4. Llojet e masave të mbrojtjes

Masat e mbrojtjes zbatohen për të siguruar mbrojtje të personit të mbrojtur nga rreziku serioz ndaj jetës së tij, shëndetit fizik apo psikik, apo ndaj personave të afërm të përcaktuar në këtë ligj. Sipas LMD-së, në kuadër të masave të mbrojtjes së dëshmitarëve, bëjnë pjesë<sup>(29)</sup>:

1. Mbajtja e fshehtë e identitetit të personit të mbrojtur<sup>(30)</sup>;
2. Sigurimi i mbrojtjes fizike të personit të mbrojtur;
3. Ndërrimi i vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimit ;
4. Ndërrimi i identitetit të personit të mbrojtur.

Seksioni për Mbrojtjen e dëshmitarëve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për mbrojtjen e dëshmitarëve të mbrojtur<sup>(31)</sup> bën propozimin për caktimin e një apo më shumë masave të mbrojtjes, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike dhe mendimin e personit të rrezikuar. Masat e mbrojtjes mund të zbatohen vetëm me pëlqimin e personit të rrezikuar. Në çdo rast

---

<sup>29</sup> Sipas proceduralistit të njohur maqedonas prof. Kallajxhiev, ekzistojnë një mori mangësish të mëdha, dhe nga mangëstëi më serioze, siç thotë ai, janë mungesa e kriterëve të qarta, kompetencat dhe procedurat për zbatimin e masave që i parasheh LMD-ja. Dr. Gordan Kallajxhiev, "Заштита на сведоци од аспект на човекови права,, (Mbrojtja e dëshmitarëve nga aspekti i të drejtave të njeriut), një përblehdje punimesh e redaktuar nga Jelena Krasiq dhe të tjerë, Заштита на сведоците, соработниците на правдата и на жртвите во домашното и во меѓународното право, GRALA Adverting, IOM-Misioni në Shkup, f. 57-9, publikuar në [http://nk.bitsia.com/sites/default/file\\_s/prikachyvanja/zashti](http://nk.bitsia.com/sites/default/file_s/prikachyvanja/zashti).

<sup>30</sup> Anonimiteti mund të sigurohet vetëm atëherë kur autoritetet kompetente të gjykatës, pasi dëgjojnë palët, do të vërejnë se jeta ose liria e personit palë në procedurë penale rrezikohet seriozisht dhe ka garanci për kredibilitetin e personave që janë dëshmitarë. Përveç këtyre shqetësimeve serioze, prof. Kallajxhiev thotë edhe atë që formulimi ligjor, për sa i përket mbajtjes së fshehtë të identitetit të personit dëshmitar i mbrojtur, ka paqartësi të mëdha, për sa i përket masave që i referohen nenit 270-a (293) ст. 3 të KPrP t RM, shih artikullin e dr. Gordan Kallajxhiev, "Заштита на сведоци од аспект на човекови права,, (Mbrojtja e dëshmitarëve nga aspekti i të drejtave të njeriut), Ibid, f. 55-6, publikuar në [http://nk.bitsia.com/sites/default/files/prikachyvanja/zashtita\\_na\\_svedocite\\_sorabotnicite\\_na\\_pravdata\\_i\\_na\\_zhrtvite\\_vo\\_domashnoto\\_i\\_megjunarodnoto\\_pravo.pdf](http://nk.bitsia.com/sites/default/files/prikachyvanja/zashtita_na_svedocite_sorabotnicite_na_pravdata_i_na_zhrtvite_vo_domashnoto_i_megjunarodnoto_pravo.pdf).

<sup>31</sup> Neni 12, LMD.

parashihet që të merret pëlqimi me shkrim i personit që propozohet për t'u futur në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, përkatësisht dakordësia e dëshmitarit për caktimin e masës së mbrojtjes. Në fakt, pëlqimi i personit, është kusht i domosdoshëm (*conditiosine qua non*) për caktimin e masës mbrojtëse. Për personat e privuar pjesërisht apo plotësisht nga zotësia e veprimit, pëlqimin e jep personi i autorizuar me ligj për përfaqësimin e tyre apo kujdestari<sup>(32)</sup>. I mituri konsiderohet se nuk është në gjendje që të kuptojë rëndësinë dhe natyrën e masave të mbrojtjes, prandaj kërkohet që të merret leja e prindit ose e kujdestarit të tij<sup>(33)</sup>. Ngjashëm me këtë, edhe për personat e privuar, qoftë pjesërisht ose plotësisht nga zotësia e veprimit, kërkohet marrja e pëlqimit nga përfaqësuesi ligjor ose kujdestari i tij.

## 5. Mekanizmat për mbrojtjen e dëshmitarëve

Mekanizmat për mbrojtjen e dëshmitarëve janë të përcaktuara në dispozitat e Ligjit nr. 38, maj 2005 “Për Mbrojtje të Dëshmitarëve”<sup>(34)</sup>. Rrjedhimisht, si mekanizma përgjegjës për të propozuar, vendosur dhe monitoruar zbatimin e masave të mbrojtjes ndaj dëshmitarëve janë:

1. Këshilli për Mbrojtjen e Dëshmitarëve<sup>(35)</sup>;

<sup>32</sup> Neni 5, LMD.

<sup>33</sup> Proceduralistja e shquar jugosllave Panta Marina thekson se “gjatë procesit të marrjes në pyetje mund të thirret i mituri dhe veçanërisht kur janë në pyetje këta kategori personash, të cilët janë të dëmtuar me vepër penale, duhet të shmangen pyetjet që dëmtojnë dinjitetin e dëshmitarit dhe që dëmshëm ndikojnë në psikikën e tyre. Nëse ndonjëri nga pjesëmarësit në procedurë nuk i përmbahet kësaj, atëherë gjykata mundet që të ndalojë parashtrimin e pyetjeve të tilla. Nëse do të jetë nevoja për praninë e pedagogut apo të ndonjë personi tjetër profesionist, vlerësohet nga organi që është duke e zhvilluar këtë veprim”, shih Др. Панта Марина, Коментар на законот за кривична постапка, (Komentar i Ligjit të procedurës penale), Скопје 1978, f. 217-22.

<sup>34</sup> Ky ligj me shtojcë botohet me nr. 58, me datë 19 korrik të vitit 2005, i sistemuar në 10 kapituj me 46 dispozita.

<sup>35</sup> Këshilli për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Mbrojtur përbëhet prej pesë anëtarëve: një gjyqtar i Gjykatës Supreme të RM-së, zëvendësprokurori Publik i RM-së, drejtori i Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve, një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe udhëheqësi i Seksionit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Mbrojtur. Secili anëtar ka edhe një zëvendës.

## 2. Seksioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Mbrojtur, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Si mekanizëm qendror, i cili lehtëson dhe ekzekuton masat e mbrojtjes ndaj dëshmitarëve, është edhe Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të së cilës funksionon edhe seksioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Mbrojtur, e cila krahas detyrimeve të tjera të përcaktuara në nenin 12 të LMD-së, vendos edhe për përcaktimin e masave të mbrojtjes si dhe për implementimin e tyre. Po ashtu, edhe Prokuroria Publike e RM-së ka rol të rëndësishëm për faktin se propozon për futje në programin e dëshmitarëve të mbrojtur deri te Këshilli për Mbrojtjen e Dëshmitarëve<sup>(36)</sup>.

### Konkluzione

Mbrojtja e dëshmitarëve është detyrë shumë e rëndësishme e drejtësisë në përgjithësi. Për shkak të rëndësisë, seriozitetit dhe ndjeshmërisë që ka në çështjet penale, mbrojtja e dëshmitarëve është e shtrirë në aspektin juridik penal.

Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit dhe vlera e dëshmisë së tij nuk ka munguar nga trajtimi në asnjë sistem të drejtësisë, duke përfshirë këtu edhe të drejtat zakonore dhe ato religjioze.

---

Mandati i anëtarëve të Këshillit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Mbrojtur, me përjashtim të drejtorit të Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve dhe udhëheqësit të Seksionit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Në Këshillin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve udhëheq kryetari, i cili me funksion është gjyqtar në Gjatën Supreme të RM-së. Këshilli punon në seanca të mbyllura, të cilat kanë karakter të fshehtë dhe vendos në mënyrë të plotfuqishme, në qoftë se në seancë marrin pjesë katër anëtarë( Neni 6-11 i LMD-së). Edhe përkundër kësaj që thamë, dilema mbetet që ky Këshill është formuar ose formohet rast pas rasti, në mënyrë ad hoc, nëse ka apo jo mbështetje administrative logjistike, si dhe ku ndodhet ose ku realizohet takimi i këtyre anëtarëve dhe nëse ka njerëz të përfshirë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, është konstatim i hulumtuesit maqedonas S. Dimosvkit, që e shpaloj këtë fakt në hulumtimin e tij dhe publikon me titull “Заштитен сведок како инструмент во македонскиот правен систем, (Dëshmitari i mbrojtur si instrument në sistemin e drejtësisë maqedonase), Sashe Dimosvski, Zashtiten svedok kako instrument na makedonskoto zakonodavstvo, Bato i Divajn, Shkup, aj 2014.

<sup>36</sup> Neni 15 i LMD-së.

Maqedonia në vitin 2005 ka nxjerrë Ligjin nr. Nr.38/05 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve”, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2006, megjithatë ka probleme të shumta në zbatimin konsekuent të ligjit, për shkak të mungesës së mjeteve financiare që kërkon implementimi i tij. Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, duhet ta vendosë si prioritet çështjen e mbrojtjes së dëshmitareve dhe për këtë qëllim të ndajë më shumë buxhet në mënyrë që ligji të zbatohet me përpikmëri. Po ashtu, ndihet nevoja që stafi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të ndjekë trajnime të aftësisimit profesional dhe të aftësohet për zbatimin konsekuent të detyrave të këtij institucioni.

Institucioni për mbrojtjen e dëshmitarëve ka për qëllim që në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi t’u mundësojë mbrojtje dëshmitarëve si pjesëmarrës në procedurën penale, dëshmia e të cilëve mund të paraqesë rrezik për jetën e tyre.

Për shkak të natyrës serioze dhe të ndjeshme që kanë çështjet penale, mbrojtja e dëshmitarëve është e orientuar në aspektin juridik dhe penal. Qëllimi i mbrojtjes së dëshmitarëve është siguria e dëshmisë së tyre në procesin gjyqësor, me qëllim të gjetjes së të vërtetës që mundëson ndëshkimin e fajtorit dhe lirimin e personave të pafajshëm, me qëllim mosekspozim rreziku nga kryerësit e veprave penale, pasi japin dëshminë e tyre.

### *Literatura e konsultuar*

- Dimovski, Sashe, *Защитен сведок како инструмент во македонскиот правен систем*, (Dëshmitari i mbrojtur si instrument në sistemin penal maqedonas), Bato&Divajn, 2014.
- Ebu Safijeh, Fakhr, *Turuk el-ithbat fi kadail islami*, (Procesi provues në gjyqsinë islame), Irbid 1994.
- El-Kasani, *Beda`iu sanai*, Bejrut 1997.
- Es-San`ani, *Subuli selam*, Kairo 1987.
- Ez-Zuhejli, Muhammed Mustafa *Usul muhakemat esher`ijje vel medenije*, (Proçesi gjyqësore penal dhe civil islam), Damask 1982.